

të kthehet prapa në rrugën e mbarë të njerëzisë, sepse „çka piqet nuk hiqet” (f. 219).

Të gjitha anekdotat e këtij bleni shquhen për shkurtësinë e tyre, për gjuhën e pastër e stilin konciz ezo-pik. Në epiqendër të tyre përmbajnë ngjarje të jetës reale. Personazhet e vendi i ngjarjes janë autoktonë burimorë, nga treva e Drenicës. Anekdotat të bartura ka shumë pak, kryesisht ato që lidhen për personazhin e Nasradin Hoxhës.

V — Në *fjalët e urta*, (gjithsej 370 sosh) shprehet ajo përvojë jetësore, e sprovuar disa herë gjatë periudhave të kaluara historike. Në të, në mënyrë të shkurtër, paraqiten dy komponente jetësore — *të përjetuarit në të kalurën e hidhur dhe këshilla dedikuar gjeneratave që pasojnë*. Po veçojmë disa nga fjalët e urta të këtij bleni që, sipas mendimit tonë, janë shumë të fuqishme. Punët nuk shkojnë mbarë aty ku punohet pas shpine e me dredhi: *Bukt simite nuk vinë ku â kaca me rasoj*. Njerëzit e nder-

shëm kanë turp e njerëzi: *Çëlsi i burrisë â marrja*. Sentencën e Naim Frashërit „Ti hiq pas kohës, koha s' vjen pas teje” e përfill edhe populli — *Duhet me konë plak, po me mën t'reja*, do të thotë duhet ecur me kohën dhe progresin shoqëror. Të mirat e harmonia i japin njeriut vullnet për jetë — *Fjala e mirë jetën ta zgjatë*. Në ndonjerën nga këto lartësohet zemërgjerësia — *Nuk â trim aj qi vret, po aj qi falë*, e shumë të tjera fjalë të urta kësisoji.

Në këto fjalë të urta spikatet, pos mendjehollësisë, zgjuarësisë e përvojës së popullit, edhe etika e shoqërisë shqiptare. Populli ynë ka krijuar norma të caktuara shoqërore, që janë bërë traditë, edhepse të pashkruara. Ai u është përmbajtur atyre normave në të kaluarën e gjer më sot.

Bleni *Proza popullore e Drenicës, II*, është paraqitur në trajtë mjaft voluminoze, duke qenë mjaft kualitative për nga zgjedhja e njësive të llojeve të ndryshme të prozës popullore.

MEHMET HALIMI

### Halil Kajtazi, NGA LIRIKA POPULLORE E DRENICËS, Prishtinë 1972, f. 202

Ky ble ka 202 faqe, në të cilat për-fshihen 138 këngë lirike, të ndara në gjashtë kapituj. Libri fillon me një parathënie, ku H. Kajtazi flet mbi rëndësinë e folklorit dhe vështirësitë që ka ndeshur, duke mbledhur këto këngë. Pas parathënies, autori i kësaj përmbledhjeje, në tetë faqe, ka bërë një vështrim të shkurtër, duke dhënë shpjegime dhe komente për këngët e secilit kapitull, veçanërisht ka komentuar më hollësisht këngët e dasmës dhe këngët shpotitëse.

Në kapitullin I janë radhitur këngët *Nina-nana* në të cilat, nëna me dashuri të sinçertë amnore i këndon foshnjës së vet. Duke e përkundur në ritmin e melodisë së djepit, ajo njëherazi e shoqëron edhe me këngë, në të cilat shpreh idealin estetik të kohës që i përgjigjet ambientit ku jeton edhe vetë. Uron që t'i bëhet djali: „çoban me dhen e me dhi”, e ta martojë „me 'i qin krushk”, që ta mbathë e ta veshë sipas shijes së

fshatarit malësor, që të rritet e të bëhet „mahallë” e „me vllazni shumë”, e të tjera.

Në këto ninulla vërehet një ideal pak i vjetëruar që është tipik për nënat sot të shkuara në moshë, sepse nëna më e re, sot, të birin a të bijën dëshiron ta shohë në rrugën e dijës, të kulturës dhe të civilizimit, ta shoh të birin në institucione të ndryshme shkollore e shtetërore.

Ky cikël ninullash është i mangët nga dy aspekte: nga një anë numri i këngëve të prezentuara është i vogël, e nga ana tjetër ndihet edhe mungesa e ninullave bashkëkohore si dhe prania e këngëve për foshnjat e të dy gjinive, për djalin dhe vajzën.

II — Në *këngë dhe lojna fëmijësh*, të mbledhura me kujdes të posaçëm, pasqyrohet bota shpirtërore e fëmijëve, horizonti i tyre dijtunor për natyrën, objektet dhe shtazët shtëpiake. Karakteri shpotitës sheh humori

i lehtë i fëmijëve, të cilët në shakatë e tyre kanë më tepër për qëllim të krijojnë një atmosferë gazmore se sa therrëse, janë poashtu një cilësi e këtyre këngëve. Ky cikël është më i plotë, madje Halil Kajtazi ka pasë botuar më parë një ble të veçantë, nergut për fëmijë me këngë dhe loj-na fëmijësh, me titull *Xingli mingli* (1967).

**Kapitulli: III, Këngë e valle dasme,** është më voluminoz dhe mund të konsiderohet si bosht kryesor i këtij bleni. Ky cikël ngërthen në vete 78 këngë. Në to kemi një gërshetim të së kaluarës me të tanishmen. Varësisht nga intervali kohor i lindjes së këngëve, vërejmë edhe idealin estetik të kohës, të shprehur në përshkrime për çiftin e ri. Një komponentë e fuqishme e tyre është shkollimi, kultura, civilizimi dhe emancipimi i shoqërisë shqiptare. Në këto këngë he-tojmë edhe shpirtin luftarak të femrës drenicake, për shembëll në këngën *Ori lulë flokt duj-duj*, ku femra shpreh dëshirën: „Partizankë deshta me shkue /M'i marrë pushkën me liftue”, etj. Shpërthen fuqishëm dëshira e tyre e flakët për shkollim, të cilën e shprehin duke ushqyer simpati ndaj vëllaut të shkolluar „Miq e nipa shkollovana” (fq. 74), „Po e martojmë ni shkollovan” (fq. 83), „Vllau jem n'Normale t'Prishtinës” (fq. 119).

Në përgjithësi këngët e dasmës përshkohen nga ngjyra e kohës, dinamika e jetës, synimet dhe aspiratat e shoqërisë së re socialiste. Megjithëse për nga numri këto këngë janë më të shumta, në këtë kapitull mungojnë këngët e parafejesës, të ditës së fjalës, këngët rituale të dasmës, të dërgimit të të hollave për përgaditjen e pajës së nuses. Mungojnë poashtu këngët e vallet e deficit, këngët rreth përgaditjes së dhëndërit (larjes, rruarjes e veshjes), që gjithashtu duhet të ketë mjaft në trevën e Drenicës.

IV — Në këngët shpotitëse, të cilat gjithashtu janë të lidhura me dasmën përqeshen e vihen në shpoti prindërit e nuses: babai, e ëma e far e fisi i saj, që kanë ngrënë shumë të holla për përgaditjen e pajës. Në këto këngë në mënyrë direkte fshikullon kamxhiku satirik, duke ngritur zërin revoltues kundër disa zakoneve e do-

keve të vjetra, të cilat peshojnë si barrë e rëndë financiare mbi supet e fshatarit tonë.

V — *Këngë të reja vajzash*, (gjithsejt 8 sosh) janë një freski e kohës së re të shoqërisë socialiste, ku po fillon emancipimi i femrës shqiptare, së cilës dita-ditës, po i hapen shtigje të reja, kushte e mundësi reale drejt progresit, krah për krah me botën mashkullore. Drenicaket gëzohen për shkollimin e vëllezërve të tyre për heqjen e çarshafit „Tash po dalim-o n'per çarshi” /S'guxon kush me na kqyr'me sy” (fq. 159); „Knon bylbyli n'pipa t'molles/ Lumet na vajzat e shkolles” (fq. 160). Ato gëzohen edhe e çmojnë shumë drejt lirinë e shtrenjt: „Kjo liri o qi na ka ardhë” (fq. 161).

Në këtë ble nuk mungojnë as këngët e rindërtimit që këndojnë për ditët e para të pasçlirimit. E motra mburret, duke qenë krenare për vëllaun e vet që ka shkuar në Sarajevë „Udhen Tites me ja marue” (fq. 164). Hapja e kursit për vajzat e rritura gjithashtu ishte një sihariç i këndshëm në ditët e para të pasluftës, për të cilin aksion ato i janë mirënjohëse udhëheqësit të dashur, Fadil Hoxhës: „Lula kuqe fleta dushkit /Lumet na vajzat e kursit” (fq. 163). Në këtë cikël bënë pjesë edhe kënga e pikllueshme dhe plot nostalgji ndaj shoqes së shpërngulur për Turqi që ka lënë një bankë të shkollës thatë „U nis pruga kah Turkija /Lamtumir' shoqet e mija” (fq. 162).

VI — Në këngë baritore, pikturohet ambienti fshatar dhe malor kultivimi i ndjenjës ndaj bujqësisë, e kryesisht ndaj blegtorisë; kopesë së deleve, qingjave e dhive, garat që bëjnë bari-njtë për mbarëvajtjen e tufës së bagëtive, e të tjera.

Në fund të blenit, në shenjë mirënjohjeje për mirëkuptimin dhe kontributin që i dhanë këngëtarët, Halil Kajtazi shënon edhe disa të dhëna biografike për ta. Pason fjalorthi i barbarizmave, provincializmave, fjalëve të rralla, të cilat autori është munduar t'i shpjegojë sa më mirë. Në një faqe, autori tregon rrugën që ka ndjekur në transkribimin e këngëve popullore autentike. Bleni përmbly-

llet me bibliografinë ndihmëse, që i ka ndihmuar autorit në mbarështrimin e këtij bleni.

Në një kapitull të veçantë, autori do të kishte mundur të përmbledhonte edhe „këngët e kapuçave” apo „të filxhanave”, të cilat mungojnë në këtë ble, e kësosh ka në çdo trevë të Kosovës, e sigurisht më tepër se çdo kund gjetkë, ka në Drenicë. Këtij bleni i mungojnë edhe këngët e pu-

nës, që kanë rëndësi të madhe. Gjithashtu mungojnë edhe këngët e motmotit dhe të festave periodike, pastaj vajet, pa të cilat bleni na duket i mëngët.

Përkundër të metave që ka bleni në fjalë, një përmbledhje e këtillë është e mirëseardhur, sepse me të folkloristika shqiptare u pasurua edhe me një ble këngësh popullore.

MEHMET HALIMI

**Nikolla F. Pavković, PRAVO PREČE KUPOVINE U OBIČAJNOM PRAVU SRBA I HRVATA. Studim nga etnologjia juridike. Botim i Institutit për të drejtën komparative, Beograd, 1972, 8<sup>o</sup> faqe 226.**

Që moti në shkencën etnologjike s'kemi pasur një studim kaq të sistemuar dhe të sintetizuar nga lëmi i të drejtës zakonore, respektivisht i etnologjisë juridike.

Këtë segment të kompleksit të të ashtuquajturave zakone juridike popullore, duke u mbështetur në burimet historike, autori e ka përcjellë në një mijë vjetët e shkuara. Punimi përfaqëson një studim të tërësishëm që është arritur me ndihmën e analizave të thella e të gjithanshme të kësaj çështjeje, në dukje të parë të imtë.

Vetë përmbajtja e këtij studimi tregon se hulumtimi i këtij problemi dhe përcjellja e këtij zakoni që nga kohërat më të kryehershme e deri më sot, kanë dhënë njohuri shumë interesante mbi burimin dhe zanafillën e këtij institucioni të së drejtës zakonore, mbi funksionin ekonomik-shoqëror të tij në rrjedhën e shekujve, duke filluar që nga çthurrja e shoqërisë klanore-fisnore e deri në ditët tona.

Zakoni i të drejtës së parablerjes është i rrënjosur aq thellë në vetëdijën popullore, sa që ky edhe sot e kësaj dite ndeshet në vese të ndryshme të vendit tonë. Madje në shekullin e kaluar e përvehtësuan edhe kodet civile të disa vendeve tona.

Studimi është ndarë në nëntë kapituj, kurse në fillim ka hyrjen dhe në mbarim përfundimin, ndërsa parathënien e ka shkruar Profesor Dr. Mirko Barjaktarović.

Së pari autori ka sjellë një pasqyrë kronologjike të mendimeve dhe të teorive mbi prejardhjen e të drejtës së parablerjes tok me vështrimet kritike rreth tyre. Nga autorët që janë marrë me këtë temë, ky përmend V. Bogishiqin, F. Spevecin, St. Novakovićin, F. Raçkin, M. Vukiçevićin, V. Nazorin, I. Strohalin, A. Solovjevin etj., si dhe ca studjues të huaj. Për teorinë e tyre flet në mënyrë kritike, duke bërë përpjekje që disa përfundime të tyre të gabuara t'i hudhë poshtë. Nikolla F. Pavković hedh poshtë „teorinë klanore” si dhe mohon ndikimin e të drejtës bizantine dhe romake. Nxjerr në pah edhe qëndrimet jodialektike të disa etnologëve të huaj, të cilët gurrën e prejardhjes të së drejtës së parablerjes e shohin në shenjtërinë e tokës dhe tek kulti i të të parëve.

Kapitulli i dytë u kushtohet burimeve dhe metodës së punës. Prej burimeve të shkruara historike, autori ka shfrytëzuar: dokumente mbi donacionet, legimet etj., testamente, kontrata shitblerjeje, kartularë, karta, statute qytetesh dhe komunash, sentenca, urbarë, kanun-name etj., si dhe kode civile. Më në fund, autori ka shfrytëzuar edhe materiale që ka mbledhur personalisht në terren, duke bërë kërkime në popull, don të thotë ka shfrytëzuar burime memoriale nga lokalitete të ndryshme të vendit tonë. Ai thotë se hulumtimet e tij janë të tërësishme e jo parciale dhe kurdoherë ka pasur parasysh diak-